



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2548 Prot.

Roskovec, më 01, 04 2021

VENDIM

NR 15 .DATË 31.03 .2021

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË TRANSPARENCËS PËR VENDIMMARRJE I
KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC PËR VITIN 2020”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe VKB Nr.20 datë 27.03.2020 “Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike” neni 43 i tij, ju paraqesim, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e Raportit të transparencës për vendimmarrje i Këshillit Bashkiak Roskovec për vitin 2020.
- 2- Bashkëlidhur këtij vendimi “Raporti i transparencës për vendimmarrje i Këshillit Bashkiak Roskovec për vitin 2020.
- 3- Ngarkohet Sekretaria e Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 4- Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2252/1 prot.

Roskovec më 23/03/2021

**RAPORTI I TRANSPARENCËS PËR VENDIMMARRJE I KËSHILLIT BASHKIAK
ROSKOVEC PËR VITIN 2020**

Referuar ligjit 146/2014, Neni 20, Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes 1. *Organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për: a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues; b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara; c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes; ç) numrin e takimeve publike të organizuara.* 2. *Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes publikohet sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij ligji, VKB Nr.20 datë 27.03.2020 "Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike",*

Referuar për sa më sipër Këshilli i Bashkisë Roskovec gjatë vitit 2020 ka marr 101 vendime në total. Nga këto vendime, 25 janë realizuar me dëgjesa publike. Për vitin 2020 janë zhvilluar në total 16 dëgjesa publike, 2 prej të cilave janë realizuar online.

Në lidhje me tematikat e vendimeve, 22 janë për çështje financash, 21 për çështje sociale dhe familjet në nevojë, 14 për çështje infrastrukturore, 5 për çështje emergjencash civile, 13 për çështje urbane dhe pronash, 26 për çështje të tjera të ndryshme.

Dëgjesat publike janë realizuar në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë, dhe nisur në kushtet e pandemisë janë realizuar në grupe të vogla. Pavarësisht situatës në mënyrë specifike për buxhetin e vitit 2021, si nga këshilli edhe nga kryetari i bashkisë janë realizuar dëgjesat publike. Në dëgjesat publike është vërejtur një rritje e pjesëmarrjes së elementit gjinor femër. Gjatë vitit 2020 në dëgjesa kanë marrë pjesë afërsisht 600 qytetarë.

Në dëgjesat e zhvilluara janë bërë propozime dhe sugjerime shumë të vlefshme, kryesisht për buxhetin dhe paketën fiskale. Këshilli dhe Bashkia kanë vlerësuar sugjerimet dhe propozimet e bëra nga qytetarët dhe janë angazhuar që ato të pasqyrohen në vendimmarrje.

Gjithashtu gjatë vitit 2020, këshilli ka realizuar disa mbledhje të cilat janë transmetuar online. Bazuar në Rregulloren e Këshillit për Konsultimet Publike, kemi hapur regjistrin elektronik të këshillit për konsultimet publike. Ky regjistër na ka ardhur në ndihmë për të zhvilluar dëgjesa publike online, edhe në raste të tilla siç është situata aktuale e krijuar nga pandemia e virusit covid-19, ku me akt normativ nuk lejohen grumbullimet më tepër se 10 veta.

Në dispozicion të qytetarëve është vendosur e-maili i sekretarisë së këshillit, në këtë mënyrë ata mund të dërgojnë komentet e tyre. Nga proces verbalët e deritanishme për dëgjesa online nuk rezultojnë ndonjë reagim ose propozim nga qytetarët.

Miratimi i Rregulloreve të Ankesave, Kërkesave Nismave dhe Peticioneve ka qenë një element shtesë dhe i rëndësishëm në punën e Këshillit pasi kjo i ka hapur rrugën banorëve të bashkisë për tu drejtuar edhe këshillit për çështje të ndryshme. Ndër këto kërkesa vlen të theksohet trajtimi i zgjeruar i shqetësimit të banorëve për furnizimin me energji elektrike. Edhe pse si kërkesë është jashtë kompetencave të këshillit, këshilli nga ana e tij e ka trajtuar shkresërisht me institucionet përkatëse, ku si rezultat i angazhimit të këshillit dhe i kryetares së bashkisë në bashkëpunim me drejtues të OSSHE u përmirësua furnizimi me energji elektrike.

Nisur nga fakti që numri i kërkesave apo ankesa nuk ka qenë i lartë në drejtim të këshillit, pasi vërehet ende forma verbale e tyre dhe jo e shkruar, këshilltarët herë pas here marrin pjesë në pritjen publike të qytetarëve që realizojnë kryetarja e bashkisë. Kjo është një formë jo vetëm për të qenë pranë qytetarëve por edhe për të risjellë në vëmendje të qytetarëve që të përdorin formatet me shkrim ose ato online për shqetësimet e tyre.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj !

Kryetar

Kadri Hyska

